

DHOMA E POSAÇME E SPECIAL CHAMBER OF THE POSEBNA KOMORA
GJYKATËS SUPREME TË SUPREME COURT OF VRHOVNOG SUDA
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE KOSOVO KOSOVA ZA PITANJA
QË LIDHEN ME PRIVATIZATION AGENCY KOJA SE ODOSE NA
AGJENCINË KOSOVARE OF KOSOVO KOSOVSKU AGENCIJU ZA
TË PRIVATIZIMIT

AC-I.-14-0169- A0001

Në çështjen juridike të,

“T” Sh.A nga Serbia, e përfaqësuar nga avokatët D. K,D.N, M.II, S.M dhe D.N, nga Zyra e Avokatisë “K&N”, nga Beogradi

Paditësi/ankuesi

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Ilir Konushevc i nr.8 Prishtinë

E paditura

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Witold Jakimko, Ondrej Pridal, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, në ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit SCC-05-0113, të datës 15 prill 2014, të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 02 prill 2015, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi SCC-05-0113 i datës 15 prill 2014 i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 11 prill 2005, paditësi “S” SH.A. parashtrou padi kundër të paditurës AKM-së. Sipas padisë, Kompania “S”, është pronarja e vetme e “F-S” SH.P.K. – ndërmarrje e shitur nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit si ndërmarrje shoqërore më 16 shtator 2004. Për

ta provuar këtë pretendim, paditësi e prezanton një vendim të lëshuar më 28 tetor 1992 nga Organi Drejtues i Përkohshëm, i NSH "F – F e T", që të bashkohet me "S", një Shoqëri Aksionare, e cila kryesisht kishte kapital privat. Më 4 nëntor 1992, Gjykata Ekonomike e Novi Sadit e regjistroi kompaninë që i mbijetoi bashkimit dhe rrjedhimisht të gjitha asetet dhe detyrimet e Fabrikës së Tapetave janë transferuar në "S". Megjithatë, Organi Drejtues i "S" vendosi që ta inkorporojë një Ndërmarrje të Re në Kosovë – që do të thotë "F-S" Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara. Më 2 dhjetor 1992, Ndërmarrja e re SH.P.K. ishte regjistruar në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë si "S" SH.A. si e vetmja themeluese.

Kjo situatë ligjore ka vazhduar të ekzistojë deri në ardhjen e Forcave Ndërkombëtare në Kosovë. Pastaj e sapoformuara Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, pas studimit të statusit të "F-S" SH.P.K. vendosi që të mos e përfillë kompaninë që ishte bashkuar dhe ta trajtojë atë si Ndërmarrje Shoqërore, që ka rezultuar me privatizimin për shumën e përgjithshme prej 3 331 250 euro.

Kërkesa e paditësit është që t'i paguhej shuma prej 3.331,250.00 euro me interes, që nga data 16 shtator 2004, deri në pagesën përfundimtare. Përveç kësaj, paditësi gjithashtu kërkoi që t'i jepet shuma prej 250,000.00 euro, për kompensimin e humbjes së profitit si rezultat i trajtimit të paligjshëm nga ana e AKM-së.

Më 26 tetor 2005, AKM-ja parashtroi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme mbrojtjen e saj ndaj padisë. AKM kërkon nga gjykata që të urdhërohet paditësi që të paraqet më shumë prova për padinë. Ndër të tjera, AKM kërkon të provohet nese aksionarët e kanë miratuar padinë e tanishme, ose janë këshilluar për veprimin e ndërmarrë nga menaxhmenti; se paditësi i vëzhgonte veprimtaritë e vartësit të saj të pohuar "F" dhe se i ka paguar aksionarët e saj; se paditësi kishte bërë ndonjë investim në vartësin e saj të pohuar "F" dhe kërkon prova se si ishte llogaritur humbja financiare e pretenduar nga paditësi.

Në vijim të mbrojtjes së AKM-së, thekson se kjo shkrimje nuk ishte e bazuar në Ligjin Federativ mbi Ndërmarrjet (i miratuar në vitin 1988 dhe i publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 77/88, më vonë i ndryshuar në vitin 1989 dhe dy herë në vitin 1990), që mund të përbënë Ligj të Zbatueshëm, sepse dispozitat e rëndësishme të këtij ligji nuk ishin zbatuar gjatë shkrimjes.

Ndryshe, e paditura pretendon se baza e kësaj shkrimje gjendet në Masat e Përkohshme për Mbrojtjen e të Drejtave të Vetë-Menaxhimit dhe Mbrojtjen Shoqërore të F- të

miratuara nga Kuvendi i Serbisë më 6 nëntor 1990. Për më tepër, e paditura pohon se ky ligji i fundit nuk nënkupton Ligjin e Zbatueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, së pari sepse nuk e plotëson hendekun legjislativ brenda kuptimit të nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24. AKM-ja pretendon gjithashtu se neni 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut paraqet një presupozim se ligjet e kaluara nga data 22 mars 1989, normalisht se nuk janë të zbatueshme dhe se barra e provave i mbetet paditësit që një ligj pas datës 22 mars 1989 nuk ishte diskriminues.

Në seancën dëgjimore të mbajtur më datën 20 qershor 2013, Trupi Gjykses e ftoi në cilësinë e të paditurës Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) si ex lege pasardhëse e ish- Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Në të njëjtën seancë dëgjimore, paditësi sqaroi se kompania paditëse (S) ishte shkruar me kompaninë e quajtur "T" SH.P.K. nga Backa Palanka, dhe si rezultat i kësaj paditësi do të duhej të konsiderohej si "T" SH.P.K. nga Backa Palanka.

Të dyja palët në këtë lëndë (paditësi dhe e paditura) konfirmuan se ato mbesin prapa padisë, përkatësisht, e paditura prapa mbrojtjes së parashtruar ndaj padisë së AKM-së më 26 tetor 2005.

Në seancën dëgjimore të mbajtur më 22 janar 2014, çështja kryesore ishte pranueshmëria dhe lidhja e dëshmisë së kërkuar. Pas seancës dëgjimore, kolegji vendosi se pranueshmëria dhe lidhja e dëshmimeve me shkrim, do të vendosej gjatë seancës vendimmarrëse për merita.

Seanca e fundit dëgjimore për këtë lëndë ishte zhvilluar më 13 mars 2014. Që të dyja palët deklaruan se nuk kanë propozime të reja për prova të tjera, andaj gjykata vendosi që ta mbyllë procedurën e provave për këtë lëndë dhe ua dha fjalën palëve për deklaratat përfundimtare.

Është e rëndësishme që të nënvizohet se të dyja palët i mbrojtën qëndrimet e tyre të mëparshme.

Pasi që të dyja palët i kërkuan shpenzimet, Gjyqtari Kryesues u dha atyre 5 ditë që ta specifikojnë shumën e shpenzimeve të kërkuara.

Më 14 mars 2014 (brenda afatit), AKP-ja iu përgjigj urdhrin të gjykatës dhe i kërkoj shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 992 euro (nëntëqindenëntëdhjetedy euro).

Më 25 mars 2014 (pas afatit), përfaqësuesi i paditësit, iu përgjigj urdhrin të gjykatës dhe i kërkoi shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 25558 euro (njëzetepesëmijepesëqindepesëdhjetetë euro).

Më 15 prill 2014, Kolegji i Specializuar ka marrë Aktgjykimin SCC-05-0113, me të cilin padia e parashtruar për kompensimin e tjetërsimit të pronës në shumën prej 3,331,250 euro dhe humbjes së profitit në shumën prej 250,000 euro, refuzohet tërësisht si e pabazuar.

Paditësi duhet t'ia paguajë Agjencisë Kosovare të Privatizimit 992 euro për shpenzimet procedurale. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi Kolegji i Specializuar thekson se pjesa kryesore e kësaj çështje gjyqësore qëndron në gjetjet e gjykatës lidhur me dy çështjet kryesore:

(1) Cilat ligje ishin të zbatueshme në shkrimin e vitit 1992 dhe a ishin zbatuar ato ashtu siç duhet. (2) A ishte thjeshtë fakti se në emër të "F" vendimi për shkrimje ishte lëshuar nga i ashtuquajti Organ i Brendshëm, i mjaftueshëm për ta konsideruar transformimin diskriminues.

Sipas paditësit, Ligji për Kompanitë do të zbatohet vetëm në vitin 1988 dhe shkrimja e kundërshtuar ishte bazuar në nenin e tij 187-a. Sipas pikëpamjes së të paditurës, tërësia e ligjeve të privatizimit, të miratuara kah fundi i viteve të 1980-ta dhe të njohura botërisht si "Ligjet e Markovicit", (sipas kryeministrit të fundit të RSFJ-së A.M) do të duhej të zbatoheshin. Prandaj shkrimja e bazuar në vetëm njërin nga ato, nuk ka efekt.

Sa i përket çështjes së dytë, paditësi e paraqet mendimin se edhe pse imponimi nga ana e Organit të Përkohshëm në NSH-në "F" ishte bazuar në ligje diskriminuese, kjo si e vetme nuk është e mjaftueshme për ta konsideruar shkrimin diskriminues. Ajo çfarë është e rëndësishme sipas paditësit është, mënyra se si ishte bërë transformimi (në këtë rast shkrimja). Fakti se shumica e punëtorëve të "F – S" SH.P.K. të cilëve u ishin dhënë aksionet falas ishin të origjinës shqiptare, dëshmon se procesi ishte zhvilluar në një mënyrë jo-diskriminuese, pretendon paditësi.

Sipas vlerësimit të gjykatës në shkallë të parë, përderisa privatizimi i pronës në fjalë ishte bërë në vitin 2004, do të zbatohet Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12. Sipas asaj Rregulloreje, neni 5.4, çfarëdo shkrimje që ka ndodhur pas datës 22 mars 1989 është e vlefshme vetëm nëse bazohet në ligjet e zbatueshme, dhe të jetë ekzekutuar në mënyrë jo-diskriminuese. Shkrimja në fjalë kishte ndodhur në vitin 1992 dhe prandaj i

përmbush të dyja kërkesat. Shkrirja ishte e tipit “marrje përsipër” – NSH “F” ishte absorbuar tërësisht nga SH.A. “S” dhe e kishte humbur personalitetin e saj ligjor. Kapitali në pronësi shoqërore i “F” ishte bërë pjesë e kapitalit kryesisht në pronësi private të kompanisë absorbuese. Prandaj, shkrirja e vitit 1992 ishte vetë shembulli klasik i privatizimit – një pjesë e kapitalit shoqëror ishte transferuar për t’u bërë pjesë e kompanisë kryesisht private. Rrjedhimisht–ligjet përkatëse të privatizimit do të zbatoheshin.

Gjykata gjeti se në kohën e shkrirjes, Ligji për Qarkullimin dhe Shitjen e Kapitalit Shoqëror (LQShKSh) i vitit 1990 ofronte rregulla lidhur me çështjet e privatizimit. Në të vërtetë, ky ligj – edhe në versionin e tij të parë të vitit 1989 – ishte miratuar pas afatit të parashikuar në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 (22 mars 1989). Megjithatë, ligji që ishte rregullorja e parë për privatizimin, nuk ishte vetë diskriminues dhe andaj duhet të zbatohet në përputhshmëri me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24. Sipas nenit 2 (1) të LQShKSh-së, një ndërmarrje mund të shitet tërësisht ose pjesërisht dhe fondet e siguruara nga kjo i takojnë Fondit për Zhvillim – një organ i veçantë i themeluar në secilën prej anëtarëve përbërës të RSFJ-së. Kontrata për shitjen/privatizimin e entiteteve në pronësi shoqërore dhe kapital do të përmbylej nga Fondi për Zhvillim siç thotë neni 2-b. Në pajtim me nenin 4 të të njëjtit ligj, agjenci të veçanta do të ofronin vlerësime mbi vlerën e kapitalit shoqëror për shitje. Shkrirja në mes të SH.A. “S” dhe N.SH. “F” e kishte efektin e shitjes për një Ndërmarrje Shoqërore të tërë dhe rregullat për privatizim do të zbatoheshin. Ndryshe, SH.A. “S” praktikisht e fitoi ndërmarrjen falas. Fakti se më vonë Menaxhmenti i Kompanisë u dha aksione falas punëtorëve të “F” është i parëndësishëm – punëtorët nuk ishin pronarët e kapitalit në pronësi shoqërore. Për sa kohë që kompania që i mbijetoi bashkimit fillestarë kishte të meta ligjore, inkorporomi i mëvonshëm i SH.P.K.-së “F-S” si dhe të gjitha ndryshimet në regjistrim dhe në statusin e Kompanisë “S”, nuk kanë pasur efekt në kapitalin në pronësi shoqërore në fjalë. Për të tërë periudhën, nga themelimi i saj deri në privatizim në vitin 2004 “F – F e T” do të duhej të konsiderohej si Ndërmarrje Shoqërore.

Kur është fjala për çështjen e diskriminimit përgjatë shkrirjes, gjykata është e mendimit se në këtë rast nuk ka rëndësi. Duke vendosur për shkrirjen pa e ndjekur procedurën e rregullt të privatizimit, Organi i Përkohshëm i caktuar për NSH-në “F” e lëshoi një vendim të paligjshëm dhe nuk ka rëndësi nëse ky vendim ishte përmbuar në mënyrë jo-diskriminuese.

Prandaj, padia për kompensim të humbjes së pronës dhe humbjes së profitit, do të refuzohen si të pabazuara.

Më 19 maj 2014, ankesë kundër Atkgjykimit SCC-05-0113 të datës 15 prill 2014 të Kolegjit të Specializuar, ka parshtruar "T" Sh.A nga Backa Pallanka- Serbi, për shkak të sic thuhet, shkelje të procedurës, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar të ligjit.

Fillimisht ankuesi e kundërshton vlerësimin e Kolegjit të Specializuar, që kishte konstatuar se, bashkëngjitja-bashkimi i "F" dhe "S", i cili është bërë 1992, ka paraqitur shembull klasik të privatizimit, duke patur parasysh se është bërë kalimi i kapitalit shoqërorë, kështu që ajo bëhet kryesisht kompani private, për këtë arsye janë zbatuar ligjet për privatizim, para së gjithash, Ligji mbi Qarkullimin dhe Disponimin me Kapitalin Shoqëror (LQDKSh). Kolegji ka vërtetuar se edhe pse Ligji LQDKSh, është aprovuar pas 22 marsit 1989, i njëjti nuk është diskriminues dhe duhet të zbatohet në përputhje me nenin 1.2 të Rregullores nr. 1999/24, të UNMIK-ut. Kolegji ka konstatuar që me vendosjen për bashkëngjitjen, pa respektuar procedurat gjegjëse të privatizimit, të cilat organi i përkohshëm ia ka imponuar NSH "F", është aprovuar Vendimi jo legal, dhe nuk është e rëndësishme se si është sjellë ai Vendim.

Sipas ankuesit, në transaksionin lëndor është zbatuar Ligji për Ndërmarrjet (fleta zyrtare RSFJ nr. 77/88, 40/89). Ligji është i vlefshëm së bashku me pjesën 1.1 të Rregullores nr. 1999/24 të UNMIK-ut, duke patur parasysh se ka hyrë në fuqi më 01 janar 1989, që do të thotë para 22.mars 1989. Neni 187, paragrafi 1, i Ligjit mbi Ndërmarrjet, parasheh që vendimet për ndryshimin statusor të ndërmarrjes (ndarja osse bashkëngjitja), i merr Organi Administrativ i ndërmarrjes. Në nenin nr. 187a, paragrafi 3, parasheh që mardhënjet reciproke të ndërmarrjeve, të cilat kanë rrjedhur nga ndryshimi statusor, do të rregullohen me kontratë. Për këtë arsye, menaxhmenti i ndërmarrjes "F " - Organi i përkohshëm, ka marrë Vendimin për bashkëngjitjen-bashkimin, gjegjësisht integrimin e ndërmarrjes "F" me ndërmarrjen "S", më 28 tetor 1992. Në përputhje me këtë shihet se është zbatuar procedura e cila është paraparë me nenin 187 a, paragrafi 1 i Ligjit për Ndërmarrjet. Përveç kësaj, ndërmarrjet "F" dhe "S", më 28 tetor 1992, kanë nënshkruar Protokolin, me të cilin kanë rregulluar mardhëniet reciproke, në përputhje me nenin 187a, parag. 3 të Ligjit mbi Ndërmarrjet.

Neni 27 i Ligjit mbi Ndërmarrjet, parasheh që ndërmarrjet e cekura në paragrafin 1 deri 4 të këtij neni, (ndërmarrjet në pronësi shoqërore, ndërmarrjet e kooperativave,

ndërmarrjet në pronësi të përzier, si dhe ndërmarrjet në pronësi private), kanë status të njëjtë, por edhe të drejta dhe obligime në treg. Duke patur parasysh këtë dispozitë, është e qartë që ndërmarrjet në pronësi shoqërore, po ashtu kanë patur të drejtë dhe obligime në procedurën e bashkimit me ndërmarrjen në pronësi private, në përputhje me nenin 187 a, të Ligjit mbi Ndërmarrjet. Nuk ekziston asnjë dispozitë me të cilën do të ndalohej bashkimi i cekur, thekson ankuesi. Sipas tij, arsyetimi i aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së Parë, është i gabuar, duke patur parasysh që kapitali shoqëror i "F", bëhet pjesë e ndërmarrjes në pronësi private. Në transaksionin ekzistues duhet të zbatohet LQDKSh. Në atë kohë kanë qenë në fuqi, gjegjësisht kanë qenë të vlefshme LQDKSh dhe Ligji mbi Ndërmarrjet, dhe nuk ka patur dispozita të cilat do t'a kishin obliguar "F" dhe "S", të zbatojnë LQDKSh në vend të Ligjit mbi Ndërmarrjet. F dhe S kanë zgjedhur t'a zbatojnë Ligjin mbi Ndërmarrjet, për arsye se kjo ka qenë në interesin e përbashkët të këtyre ndërmarrjeve, duke marrë parasysh se kjo ka qenë mënyra më efikase që të fillohet bashkëpunimi afarist. Përveç kësaj, ligjshmëria e këtyre transaksioneve po ashtu vërtetohen edhe me faktin që ai transaksion (bashkimi dhe ndarja) kanë qenë të regjistruara te organi kompetent i pushtetit, dmth. në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë dhe në gjykatën Ekonomike në Novi Sad.

Po ashtu, duhet të kihet vëmendja që Rregullorja 2002/12, parasheh që bashkangjitja-bashkimi, mund të bëhet në rastet kur janë në pyetje ndërmarrjet në pronësi shoqërore, në mënyrën si është përshkruar në nenin 5.4 të kësaj rregulle. Neni 5.4 parasheh si vijon: *"Riregjistrimi ose bashkimi i ndërmarrjeve në pronësi publike ose shoqërore, pas 22 marsit 1989, do të ketë ndikim në statusin e asaj ndërmarrje, si ndërmarrje publike, ose ndërmarrje në pronësi shoqërore, vetëm nëse ai riregjistrim ose bashkim ka qenë: E kryer në bazë të ligjit në fuqi dhe nëse është zbatuar në mënyrë jodiskriminuese.*

Pa marrë parasysh në atë që u cek më lart, mbi cilën do bazë që është mbështetur për transaksionin lëndorë qoftë të ketë qenë edhe Ligji mbi Ndërmarrjet ose LQDKSH, transaksioni ka qenë i lejuar sipas ligjit në fuqi. Bashkangjitja dhe ndarja e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, është e lejuar sipas Ligjit për Ndërmarrjet (i cili vlen në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/12, duke patur parasysh se është aprovuar më 22 mars 1989. Po ashtu transformimi i kapitalit shoqëror në kapital privat është i lejuar në përputhje me LQDKSH (i cili i është vlefshëm duke patur parasysh se nuk është diskriminues, në përputhje me pjesën 1.2 të UNMIK-ut Rregullorja 1999/12. Baza e transaksionit të caktuar, është ajo që është e vlefshme për zbatimin e nenit 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, jo hapat të cilët është dashur të ndërmerren gjatë

procesit të implementimit të këtij transaksioni. Duke patur parasysh të gjitha ato që u cekën më parë, bashkimi dhe ndarja e “F”, ka qene i bazuar në ligj të vlefshëm. Prandaj, kushti i parë sipas nenit 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 ka qen i plotësuar. Kushti i dytë se transaksioni është implementuar në mënyrë jo diskriminuese, po ashtu ka qen i plotësuar, sikur që do të skjarohet në paragrafin vijues.

Në seancën dëgjimore të mbajtur më 22 janar 2014, i padituri ka vërtetuar se e vetmja pyetje e cila mbetet kontestuese në mes të palëve është çështja, nëse masat e përkohshme kanë qenë diskriminuese ose jo. E paditura, nuk e përmend mënyrën jodiskriminuese të bashkimit, si kontestues. Kjo është e mjaftueshme që Gjykata të konstatoj se është plotësuar kushti i dytë nga neni 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12. Kjo, sipas ankuesit vërtetohet para së gjithash me faktin se gjatë procesit nuk ka pasur të përjashtuar nga puna të të punësuarve shqiptar. Në këtë kuptim, duhet të ceket se i padituri ka siguruar prova në raport me përjashtimin e punëtorëve, gjë që ka ndodhur para bashkimit të “F”. Megjithatë, shkarkimi i z. S.S, që ka ndodhur në dhjetorë 1990, kurse përjashtimi i z. R.Z, në tetor të vitit 1991. Bashkimi i “F” është bërë në tetor 1992, kurse këto përjashtime nuk mund të kenë qenë pengesë për bashkim dhe nuk vërtetojnë të thëniet e të paditurës, se është në pyetje mënyra diskriminuese e bashkimit të “F”. I paditura nuk ka ofruar asnjë provë se ka patur përjashtime pas bashkimit (sepse nuk ka patur përjashtime të punëtorëve).

Në lidhje me SDR me të cilën e paditura, po ashtu ka dëshiruar të tregoi që pas bashkimit të “F”, kanë pasuar veprimet diskriminuese. Paditësi konstaton që SDR, përmban gabime. Për shembull, nën pikën b 2.4 SDR, gabimisht është cekur që shefi i shërbimit juridik, është përjashtuar për shkaqe politike më 1993. Për më tepër zonj. S. Gj, shefe e njësisë juridike ka vazhduar të punoj në “F”, deri më 1999. Në pikën B 8.2, ceket se regjistrimi i shoqërisë si “F-S”, argument që Serbia e konsideron kompaninë si shoqërore, deri sa ekstrakti i bashkangjitur, nga regjistri gjyqësor, tregon që kompania është në pronësi private. Është shumë e kjartë që qëllimi i SDR-s ka qenë, jo që të tregoj mënyrën në të cilën është kryer bashkimi i “F”, por që të paditurës t’i ofroi bazë për të anuluar bashkimin, dhe pastaj që “F” të shitet, kinse bashkimi kurrë nuk ka ndodhur.

Ankuesi përsëritë dhe citon nenin 5.4, të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 i cili rregullon: “Riregjistrimi ose bashkëngjitja e ndërmarrjes shoqërore ose publike pas 22 mars 1989, ndikon në statusin e saj, si ndërmarrje shoqërore ose publike, vetëm nëse ky riregjistrim ose bashkëngjitime: Është e bazuar në ligjin në fuqi, dhe e bërë në mënyrë

jo diskriminuese. Fakti që Organi i përkohshëm ka administruar me “F”, në kohën e bashkimit të “S”, nuk mund të konsiderohet diskriminim në vetëvete, për arsye si vijon: (i) shumica e të punësuarve ende ka qenë të nacionalitetit shqiptar, (ii), asnjë nga të punësuarit shqiptar nuk është larguar nga puna, (iii) shqiptarët e e punësuar kanë patur të njëjtin status si para bashkimit, kanë fituar aksione pa pagesë në “S”, gjë e cila nuk është kontestuese në mes të palëve.

Nga të gjitha këto fakte e argumente, ankuesi propozon që Kolegji i Apelit në tërsi ta ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar SCC-05-0113, të datës 16 prill 2014, dhe që të pranohet kërkesa e paditësit dhe të obligohet e paditura që paditësit t'i paguaj shumën prej 3.331.250 €, me kamatë nga 16 shtator 2004, deri në pagesën e fundit, si dhe të paguaj paditësit shumën prej 250.000 €, me kamatë, dhe t'ia kompensoj paditësit shumën prej 25.558 €, për shpenzimet procedurale, ose ta anuloj në tërsi Aktgjykimin e ankimuar.

Më 29 maj 2014 AKP ka parashtruar përgjigje në këtë ankesë, e në të cilën thuhet ndër të tjera se, AKP në tërësi e kundërshton ankesën, duke e konsideruar si të pabazuar në ligj. Përfaqësuesit e ankuesit vetëm se kanë kanë përsëritur deklaratimet e tyre të pabazuara të paraqitura më herët në procedurë, dhe nuk kanë dëshmuar se ka pasur ndonjë shkelje të pretenduar. Për këtë arsye, AKP e mbështet aktgjykimin e kundërshtuar dhe e konsideron atë si të drejtë dhe të ligjshëm.

AKP propozon që të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet aktgjykimi i kundërshtuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pabazuar.

Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033 për DHPGJS-ë (në tekstin e mëtutjeshëm(Shtojca), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Apelit, pasi që trajtoi në mënyrë të kujdesshme të gjitha pretendimet ankimore, aktgjykimin e ankimuar dhe të gjitha provat që janë të parashtruara në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e Kolegjit të Apelit

Ankuesi e ka kundërshtuar aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar në të gjitha pikat e arsyetyimit të tij.

Ankuesi parafrazon nenin 27 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, që sipas tij, parasheh që ndërmarrjet e cekura në paragrafin 1 deri 4 të këtij neni, (ndërmarrjet në pronësi shoqërore, ndërmarrjet e kooperativave, ndërmarrjet në pronësi të përzier, si dhe ndërmarrjet në pronësi private), kanë status të njëjtë, por edhe të drejta dhe obligime në treg. Sipas ankuesit, duke patur parasysh këtë dispozitë, është e qartë që ndërmarrjet në pronësi shoqërore, po ashtu kanë patur të drejtë dhe obligime në procedurën e bashkimit me ndërmarrjen në pronësi private, në përputhje me nenin 187 a, të Ligjit mbi Ndërmarrjet, dhe nuk ekziston asnjë dispozitë me të cilën do të ndalohej bashkimi i cekur, thekson ankuesi

Duke u bazuar në këto pretendime të ankuesit, Kolegji i Apelit ka gjetur se paragrafi një dhe katër, i nenit 27 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, të cilit i referohet ankuesi, parasheh decidivisht se për vendimin mbi bashkangjitet e një ndërmarrjeje tjetër nga ndërmarrja që bashkangjitet, është i domosdoshëm pëlqimi i Këshillit të Punëtorëve të asaj ndërmarrjeje. Nga faktet e prezantuara në shkresat e lëndës del që këtë vendim, përmes një Protokollit, të nënshkruar nga anëtarët e organit të përkohshëm të “F”- i instaluar nga Serbia, dhe një përfaqësuesi të SHA “S”, e kanë marrë pa asnjë pjesëtar të nacionalitetit shqiptar, dhe me këtë është lejuar bashkimi i NSH “F” me SH “S nga Serbi. Me këtë rast, është marrë një vendim jo legal, sepse është marrë nga organi i përkohshëm, pa lejen e Këshillit të Punëtorëve, i cili përfaqëson interesin dhe vullnetin e punëtorëve.

Kolegji i Apelit gjithashtu gjeti se konform nenit 14 të Ligjit mbi Ndërmarrjet (Gazeta Zyrtare nr 77, 31 dhjetor 1988). “për organizimin e organizatës themelore të punës së bashkuar, vendosin punëtorët në përputhje me Statutin e ndërmarrjes”. Ndërkoh, Statuti i kësaj NSH-je këtë çështje e ka rregulluar në nenin 13, ku thuhet se “punëtorët mund të bëjnë ndryshime në organizimin e ndërmarrjes, ashtu që mund të bashkohet, t’i bashkangjitet një ndërmarrjeje tjetër, apo të ndahet në dy e më

shumë ndërmarrje. Lidhur me ndryshimet dhe organizimin e ndërmarrjes, punëtorët vendosin me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të punëtorëve përmes referendumit”.

Nga kjo që u citua më lartë, është e qartë se në rastin konkret, ndryshimet në ndërmarrje janë bërë në kundërshtim të plotë me nenin 13 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, dhe në kundërshtim me nenin 13 të Statutit të Ndërmarrjes.

Sipas ankuesit, neni 187, paragrafi 1, i Ligjit mbi Ndërmarrjet, parasheh që vendimet për ndryshimin statusor të ndërmarrjes (ndarja ose bashkëngjitja), i merr Organi Udhëheqës i ndërmarrjes. Ankuesi gjithashtu citon nenin 187a, paragrafi 3, të Ligjit mbi Ndërmarrjet, i cili parasheh që mardhënjet reciproke të ndërmarrjeve të cilat kanë rrjedhur nga ndryshimi statusor, do të rregullohen me kontratë.

Kolegji i Apelit ka gjetur se neni 187 i Ligjit mbi Ndërmarrjet, nga 29 dhjetori 1988, të cilit i referohet ankuesi, me Plotësimet dhe Ndryshimet këtij Ligji më 08 gusht 1990, ky nen (187) ishte fshirë, duke u shtuar neni 187a, që fliste për ndryshimet statutare. Ky ndryshim i Ligjit bazik, në bazë të të cilit edhe është marrë vendimi, ka ndodhur pas periudhës së paraparë me nenin 1.1 dhe 2 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 1999/24, sepse ndryshimi i këtij ligji ka ndodhur më 08 gusht 1990.

Për këto arsye, edhe këto pretendime ankimore janë të babazuara.

Kolegji i Apelit gjenë se fillimisht, Vendimi ishte marrë nga një organ i përkohshëm, në kohën e futjes së masave të dhunshme në të gjitha ndërmarrjet e Kosovës, fakte këto të njohura botërisht, dhe vendimet e këtij organi kanë qenë arbitrare dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore. Pra, vendimi është marrë nga një organ jo kompetente, andaj vendimi i tillë ishte i paligjshëm që nga fillimi.

Në anën tjetër, sa i përket kërkesës tjetër ligjore të nenit 187a, paragrafi 3, i cili parasheh që “mardhënjet reciproke të ndërmarrjeve të cilat kanë rrjedhur nga ndryshimi statusor do të rregullohen me kontratë”, në këtë rast nuk kemi asnjë marrdhënie të tillë reciprociteti, sepse këtu kapitali shoqëror i “F” është falur tek një kompani private. Kjo është edhe në kundërshtim me Ligjin mbi Qarkullimin dhe Disponimin e Kapitalit Shoqëror, i cili në nenin 2 flet për shitjen e këtij kapitali, dhe për organin i cili mund të marrë një vendim për këtë shitje, e që është Këshilli i Punëtorëve. Përkundrazi, në rastin konkret kemi falje, apo shkrirje të kapitalit shoqëror të NSH “F”, tek një Shoqëri Aksionare në Serbi, që paraqet një shembull tipik të vendimeve arbitrare dhe jo legale.

Kolegji i Apelit ka gjetur se vërtetë, siç ka theksuar edhe ankuesi, një numër i madh i punëtorëve shqiptarë kishin mbetur në punë, madje edhe iu kishin shpërndarë akcione.

Megjithatë problemi qëndron në faktin se a mbeti në punë ndonjëri prej udhëeqësve shqiptarë të NSH-së. Nëse shikohet në procesverbalin e datës 28 tetor 1992, ku është diskutuar procedura e këtij bashkimi dhe për arsytet e këtij transformimi të "F", shihet se prej 6 anëtarëve të Organit të Përkohshëm të kësaj ndërmarrjeje, asnjëri prej tyre nuk ishte shqiptar.

Kjo e vërteton momentin tjetër shumë të rëndësishëm, se të gjitha procedurat e transformimit i kishte marrë organi i dhunëshëm, apo i përkohshëm, i instaluar nga pushteti në Beograd, pa asnjë udhëheqës të deriatëhershëm shqiptarë, por edhe pa asnjë leje nga Këshilli i punëtorëve. Edhe pse një numër prej këtyre punëtorëve ende ishin në punë, udhëheqësit e kësaj NSH-je ishin pushuar nga puna, sepse ata ishin zëvendësuar me udhëheqje të dhunshëm, ndërsa fuqia punëtore e cila u duhej për vazhdimësinë e prodhimit, kishte mbetur ende të punoj.

Për të gjitha arsytet e lartcekura, Kolegji i Apelit konstaton se pretendimet ankimore të paditësit, nuk janë të bazuara, andaj ankesa refuzohet si e pabazuar, ndërsa rrjedhimisht vërtetohet atktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar, si i derejtë dhe i bazuar në ligj.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, dhe konform nenit 10.10 të LDHPGJS-së, Kolegji i Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Taksat Gjyqësore

Pasi që tashmë ankuesi ka paguar 100 euro në emër të taksave gjyqësore, ai nuk ngarkohet me taksë shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 02 prill 2015

Mr. sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
